



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, më 21.05.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Anton Quni, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Rexhep Selimi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 25.04.2012
3. Realizimi i Planit të Komisionit për periudhën Janar-Maj 2012;
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura, më 25.04.2012.

Kryetari i Komisionit- A ka vërejtje për procesverbalin e datës 25.04.2012? Meqenëse nuk ka vërejtje, e konsiderojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25.04.2012.

3. Realizimi i Planit të Komisionit për periudhën Janar-Maj 2012.

Kryetari i Komisionit- Në bazë të Planit të Komisionit do të bëjmë adresimin e veprimeve që janë bërë gjatë muajit janar e deri në muajin maj, lidhur me angazhimin e Komisionit.

A keni për të shtruar çështje për këtë periudhë?

Fatmir Xhelili- Shumica e aktiviteteve të planifikuara është realizuar, duke përjashtuar vizitën në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Planifikimi për këtë vizitë ka qenë i hershëm, pasi tani ka filluar strukturimi i kësaj Agjencie, kjo vizitë mund të baret për në gjashtëmujorin e dytë.

Kryetari i Komisionit- Propozoj që Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ta vizitojmë në javët në vazhdim, pasi kjo do të na mundësonte të njohim më afër kushtet e punës dhe problemet që ballafaqohen si institucion i ri.

Për periudhën në vazhdim, kam disa propozime të cilat po i lexoj:

Vizita në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, javën që vjen. Data e saktë do të vendoset në koordinim me Agjencinë.

Vizitë në Qendrën e Trajnimeve dhe Doktrinës së Forcave të Sigurisë së Kosovës në Ferizaj dhe Komandën e Forcave Tokësore. Këto vizita mund të bëhen në të njëjtën ditë. Afërsisht këto vizita mund të bëhen në javën e parë ose të dytë të muajit Qershor.

Vizitë në Akademinë Policore në Vushtri, afërsisht gjatë javës së tretë të muajit Qershor.

Në javën e fundit të muajit Qershor, vizitë në Qendrën e Situatave, për të parë punën dhe kushtet e punës.

Nëse keni propozime për ndonjë vizitë në ndonjë institucion mund të propozoni, që të përfshihet në Planin e Komisionit.

Fatmir Xhelili- Propozoj që të realizohet një takim me përfaqësuesit e Agjencisë Antikorrupsion, për të parë orientimet e tyre. Agjencioni në fjalë nuk është duke dhënë rezultate produktive për funksionin që ka, ashtu siç strategjia e propozuar nga ana e tyre në Kuvend nuk u miratua pasi u konsiderua jo mjaftueshëm e qëlluar, prandaj konsideroj që duhet të kemi një takim me përfaqësuesit e Agjencisë.

Kryetari i Komisionit- Përkrah propozimin e z. Fatmir Xhelili, pasi Agjencia kundër korrupsionit, me të dhënat që posedon i plasun dhe një pjesë të tyre i fsheh për publikun, dhe rezultati i punës nuk është produktiv. Kjo vërehet në dorëzimin e lëndëve në Prokurori, të cilat nuk procedohet më tutje, duke mos kryer punën e tij që është ndalja e korrupsionit, prandaj konsideroj se është e domosdoshme ndryshimi i mënyrës së funksionimit të kësaj Agjencie.

Edhe pse ekziston struktura ligjore për këtë fushë, dënimet e dhëna janë qesharake, prandaj duhet të ndryshohet mënyra e veprimit ose ngritja e një institucioni tjetër më të përgjegjshëm. Nëse nuk keni për të shtuar ndonjë propozim, këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj të mbyllur.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë të rendit të ditës ju njoftoj për vizitën studimore në Slloveni që kemi pasur disa anëtar të Komisionit. Ky seminar ka qenë i dobishëm sidomos për hartimin e Projektligjit për përgjimet e telekomunikimit, si dhe përvojat nga shtetet e ndryshme. Në këtë seminar kanë ligjëruar ekspert të vendeve të ndryshme si Slloveni, Kroaci, Belgjikë, Gjermani, Finlandë.

Komisioni ka realizuar edhe një punëtori të organizuar nga GIZ-i, i pranishëm ka qenë ish-Komisionari i Forcave të Armatosura të Gjermanisë, z. Reinhold Robbe. Gjatë kësaj punëtorie kemi paraqitur kërkesat dhe nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, mundësinë e forcimit të këtij institucioni, mbështetje për këtë është ofruar edhe nga përfaqësuesi i Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.

Me z. Robbe kemi bërë një vizitë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ferizaj. Z. Robbe është ndarë i kënaqur me punën dhe funksionimin e këtyre mekanizmave të sigurisë.

Në takim me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, është premtuar vizita e Ministrit të FSK-së në Gjermani me Ministrin e Mbrojtjes të Gjermanisë për zhvillimin e më tutjeshëm të FSK-së.

Gjithashtu ju njoftoj që nga angazhimi që kamë marrë për tu takuar me Shoqatën e Gjahtarëve të Kosovës për padrejtësinë, siç e quajnë ata, bazuar në Ligjin në fuqi, pasi janë të detyruar që për të dytën herët të testohen dhe të certifikohen. Ata kërkojnë që në bazë të një vendimi që është lëshuar nga Ministri i Punëve të Brendshme deri me 1 nëntor 2012 dhe që mund të mos vazhdoj.

Duke qenë se ligji bie në kundërshtim me vendimin e Ministrit, dhe ka një mospërputhje mes Ligjit për Armët dhe Ligjit për gjuetinë, propozoj që si Komision të kemi një takim me administratën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të krahasuar dy ligjet në fjalë, duke kërkuar ndryshimin e tyre, pasi të dy ligjet kanë kolizion.

Propozoj formimin e një grupi punues që do të merret me këtë çështje. Propozoj z. Fatmir Xhelili dhe z. Anton Quni. Duke qenë se jam në rrjedha të ngjarjeve, pjesë e grupit punues do të jem edhe unë, me qëllim të harmonizimit të këtyre ligjeve. Çështje shqetësuese për gjahtarët është numri i madh i gjahtarëve ilegal të cilët e dëmtojnë faunën, prandaj vendosja e rregullit është e rëndësishme.

Nëse nuk keni për të shtuar me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi